



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER MARGALINA Y. DAUTI
ADRESA Rruga "Muhamet Gjollësia,
Pall. Moskat, shk 3, ap 14"
TEL: 692204572



KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(AKSIONE)

Nr. repertori: 5429

Nr. koleksioni: 2827

Tirane më 09/11/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



A2021050360246031784

***Akti noterial përbëhet nga 3 fletë**



A2021050360246031784

**KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI
(TË SHOQËRISË “ALPET ENERGY” SH.P.K)**

Sot, më datë 09.11.2021, para meje Notere MARGALINA Y. DAUTI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tiranë, Rruga “Muhamet Gjollësia, Pall. Moskat, shk 3, ap 14”, u paraqit personalisht:

SHITES: Kevin Bajraktari, atësia Tahir, amësia Sabrie, shtetas Shqiptar, lindur në Fierzë, Tropojë dhe banues në Tiranë, lindur më 09/03/1981, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 037616307 dhe nr. personal I10309072N.

BLERES: Ingrid Staro, atësia Nedai, amësia Luljeta, shtetas Shqiptar, lindur në Bilisht, Devoll dhe banues në Tiranë, lindur më 21/04/1990, gjendja civile “i martuar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035636345 dhe nr. personal J00421034S.

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë “ALPET ENERGY” SH.P.K, sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

Neni 1

Përshkrimi i objektit

Shoqëria “ALPET ENERGY” SH.P.K., është themeluar në Shqipëri me date 05/06/2019 dhe ka një kapital prej 100 LEKE (njëqind leke) të ndare në 1 kuota, në vlerën 100 Leke (njëqind leke) të zotëruar nga ortakut i vetëm Kevin Bajraktari.

DUKE QENE SE Shitesi dëshiron të shesë kuotën e tij që përben 100% të kapitalit të shoqërisë “ALPET ENERGY” SH.P.K, dhe Bleresi në ekzekutim të kësaj Kontrate shpreh vullnetin të blejë keto kuota shoqërisë “ALPET ENERGY” SH.P.K, sipas përcaktimeve dhe kushteve të vendosura në këtë kontratë.

NE PERPUTHJE ME SA ME SIPER u parashtruan, premtimet e ndërsjella, marreveshjet, perfaqesimet dhe garancite e përmbajtura në këtë dokument, si edhe sipas përcaktimeve dhe kushteve të vendosura në këtë kontratë, Shitesi dhe Bleresi bien dakord si vijon:

Cdo marreveshje paraprake e arritur mes palëve sa më sipër pranohet dhe miratohet si pjesë e dispozitave vazhduese.

Neni 2

Palët e kontratës

1. Palët e kësaj kontrate janë:
 - a. Z.Kevin Bajraktari referuar në këtë kontratë si Shitësi; dhe
 - b. Z.Ingrid Staro, referuar në këtë kontratë si Blerësi;
2. Palët dhe/ose përfaqësuesit e palëve sa më sipër gëzojnë të gjitha tagrat për të përfaqësuar personin e tyre fizik në pranimin e termave të kësaj kontrate dhe nënshkrimin e saj.
3. Palët i kanë paraqitur njëra tjetrës gjithë autorizimet që legjitimojnë pranimin e tyre në këtë kontratë dhe i kanë pranuar ato si të vërteta dhe të rregullta.

Neni 3

Objekti i kontratës

Objekti i kesaj kontrate eshte shitblerja e kuotes në masën 100 % te kapitalit te shoqerise "**ALPET ENERGY**" SH.P.K., e zoteruar nga ortaku Kevin Bajraktari .

Kuota do ti shitet **Z.Ingrit Staro**.

Ne momentin e nenshkrimit te kesaj Kontrate Shitje Kuotash ortak i Shoqerise "**ALPET ENERGY**" Sh.p.k do te jete si me poshte vijon:

1. **Z. Ingrit Staro**, zoteron 100 % te kuotave,

Neni 4

Baza ligjore

Kalimi i kuotave me kete kontrate bazohet ne nenin 73 te ligjit nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret; dhe shoqerite tregtare" i ndryshuar.

Neni 5

Garancite e ndërsjella

Shitesi garanton Bleresin se eshte pronar me te drejta te plota mbi objektin e kontrates, e zoteron te plote dhe te lire e pa asnje barre renduese dhe se te gjitha garancite e treguara dhe te pranuar nga Bleresi, vazhdojne te mbeten te vlefshme deri ne ekzekutimin e plote te kesaj kontrate si dhe ne çdo moment pas permbushjes se kontrates.

Neni 6

Vlera e kontratës

1. Pala Shitese ka rene dakord t'ia shese Pales Blerese objektin e kesaj kontrate, me nje cmim prej 100'000 leke (njqind mije leke) dhe Bleresi ka rene dakord t'ia bleje Shitesit perkatesisht objektin e kesaj kontrate, me kete cmim.
2. Me nenshkrimin e kesaj kontrate, Shitesi pranon se pagesa sa me siper do te kryhet nga Bleresi nepermjet bankes dhe do te konsiderohet e likujduar me depozitimin e mandatit te bankes prane kesaj zyre, i cili do te jete pjese perberese e kesaj kontrate dhe Shitesi nuk ka me asnje pretendim lidhur me kryerjen e pageses sipas kesaj kontrate.

Neni 7

Transferimi i kuotës

1. Transferimi i kuotës do te behet duke ekzekutuar kontraten nepermjet regjistrimit te transferimit ne regjistrin tregtar. Regjistrimet kryhen ne perputhje me afatet ligjore.
2. Palet konfirmojne se pas ekzekutimit te kesaj kontrate dhe perfundimit te procedurave per kalimin e kuotës vetem per efekt te kesaj kontrate, **Z.Ingrit Staro** do te jetë ortak i vetem i shoqerise "**ALPET ENERGY**" Sh.p.k, duke zoteruar 100 % te kuotave.


Neni 8

Detyrime të shitësit dhe blerësit

Shitesi dhe Bleresi kane detyrimin qe te permbushin me rigorozitet kushtet e percaktuara ne kete kontrate.

Shitesi dhe Bleresi jane pergjegjes ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotave, nga casti i kalimit te kuotave deri ne regjistrimin e kalimit te tyre ne regjistrin tregtar.

Pala Blerese deklaron se merr persiper te pergjigjet perkatesisht per detyrimet fiskale qe mund te aplikohen per shkak te kalimit te kuotave, dhe cdo detyrim qe mund te lindi ne te ardhmen.





A2021050360246031784

Pala shitesë deklaron se merr persiper te pergjigjet per cdo detyrim te mundshem qe ka Shoqeria aktualisht, para nenshkrimit te kesaj kontrate.

Neni 9

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët angazhohen qe te zgjidhin me mirekuptim te gjitha mosmarrëveshjet qe lindin gjate permbushjes se kesaj kontrate. Ne rast te mos zgjidhjes se mosmarrëveshjeve me mirekuptim, palet kane te drejte ti drejtohen Gjykates se Tiranes.

Neni 10

Anekset e kontratës

9.1 Kësaj kontrate i bashkëlidhen si pjesë përbërëse dhe të pandarë këto dokumente që do të quhen Aneksë të Kontratës;

- Vendimi i Asamblesë së Ortakëve me nr. 3, datë 08.11.2021.
- Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar për Shoqërinë "**ALPET ENERGY**" SH.P.K.
- Informacioni i marrë nga Regjistri i Barrëve Siguruese, Tiranë;
- Faturë e transfertës bankare;
- Certifikatë familjare e palës Shitëse;
- Dokumentet e identifikimit të palëve kontraktuese.

Neni 11

Dispozitat përfundimtare

13.1 Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

13.2 Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre.

13.3 Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

PALËT KONTRAKTUESE

PALA SHITËSE
KEVIN BAJRAKTARI

PALA BLERËSE
INGRIT STARO

KEVIN BAJRAKTARI



NOTERE
MARGALINA Y. DAUTI

INGRIT STARO

SHOQËRIA "ALPET ENERGY" SH.P.K

Me seli ne Kukes , Tropoje , Lagjia "Kasaj" , Rruga "Trojet"

**VENDIM
I ASAMBLESE SE ORTAKEVE
Nr.3 date 08.11.2021**

Sot me date 08.11.2021 Shoqeria "ALPET ENERGY" SH.P.K person juridik i tatueshem me nr. NIPT-i L99210601A me ortake:

Z. Kevin Bajraktari, atësia Tahir, amësia Sabrie, shtetas Shqiptar, lindur në Fierzë, Tropojë dhe banues në Tiranë, lindur më 09/03/1981, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me nr. personal I10309072N.

Me vendim Nr.3 date 08.11. 2021 asambleja e ortakeve te shoqerise "ALPET ENERGY" SH.P.K , ne mbështetje te Ligjit "Per Shoqerite Tregtare".

V E N D O S I

Te transferoj kuotat e kapitalit me ane shitjes te shoqerise "ALPET ENERGY" SH.P.K ne masen 1 kuote qe perbejne 100 % te kapitalit te shoqërisë "ALPET ENERGY" SH.P.K me vlere 100.000, qe i perkasin ortakut te vetem Kevin Bajraktari, te cilat do transferohen ne dobi te Ingrid Staro, duke perfituar:

- **Ingrid Staro** - 100 % te kapitalit te shoqerise

Pas regjistrimit te vendimit dhe kontratës së shitjes te kuotave, ortak i vetem i shoqerise do te jete **Ingrid Staro** i cili do te zotëroje 100 % te vleres se kapitalit te shoqerise qe perfaqeson 1 kuote te kapitalit te shoqerise

*Depozitim e vendimit prane QKB.

Vendimi i mesiperm merret nga ortakët, bazuar ne nenet perkatese te statutit te shoqerise, si dhe te Ligjit "Per Shoqerite Tregtare"

ORTAKU I SHOQERISE

KEVIN BAJRAKTARI

KEVIN BAJRAKTARI




REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit të Kërkimit: D-2021110916258509
Data e Rezultatit të Kërkimit: 09.11.2021
Ora e Rezultatit të Kërkimit: 4:25:08PM
Lloji i Kërkimit:
Numri i Dokumentit: D-400-481-1107
Referenca e Përdoruesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KËRKIMI 0

ALPET ENERGY SH.P.K.



Florida Dardaj

Formular Urdhër Transferte

Transfer Order Form

Reference: 010P-AS-6616

Banka Bank	First Investment Bank - Albania	Dega Branch	Twin Towers	Datë* Date	10.11.2021
☐ Brenda Bankës Within Bank		☒ Brenda Vendit National		☐ Jashtë Vendit International	
☒ Normale* Normal		☐ Urgjente* Urgent			
IBAN*(Klienti urdhërues) IBAN(Ordering Customer)		AL46 2151 1031 ALL1 0000 1068 4000			
Klienti urdhërues* Ordering Customer		INGRIT NEDAI STARO			
Adresa(Klienti urdhërues) Address (Ordering Customer)		TIRANE RR 3 DESHMORET PALL LNK			
Shuma* (shifra/fjalë) Amount (figures/words)		100'000.00		Monedha* Currency	
		njëqind mijë		ALL	
				Kursi i këmbimit Exchange rate	

Komisionet Bankare* Details of Charges	☒ SHA Gjithsecili paguan komisionet e veta Each client pays his own commissions	☐ OUR Komisionet të paguhen nga klienti urdhërues Commissions to be paid by the ordering customer	☐ BEN Komisionet të paguhen nga klienti përfitues Commissions to be paid by the beneficiary customer
Kodi SWIFT* SWIFT Code	US2LACTR		
*Të dhënat e Bankës përfituese, informacion shtesë (emri bankës, banka ndërmjetëse etj...) Beneficiary Bank Data, additional Information (Bank name, intermediary Bank, etc...)	INTESA SANPAOLO BANK		
Nr.llog./IBAN(Klienti përfitues)* No./IBAN(Beneficiary Customer)	AL22720811010000037360038001		
Klienti përfitues* Beneficiary Customer	KEYIN BAYRAKTARI		
Adresa(Klienti përfitues) Address (Beneficiary Customer)	Tirane		
Qëllimi i Pagesës Remittance Information	KALIM SIPAS KONTRATE SHITJE PASURI E PALUAJTSHME (AKSIONE) NE REP 5429 NR KOL 2827 DT 09.11.2021		
Kodi i Pagesës Payment code			
Informacion shtesë Additional Information			

Deklaroj se kam lexuar dhe jam dakort me deklaratat në faqen e pasme të këtij formulari.
 I declare that I have read and agree with the declarations in the backside of this form.

INGRIT NEDAI STARO
 Nënshkrimi i Klientit Urdhërues* / Signature of the Ordering Customer
 Vula e Kompanisë* / Stamp of the Company

Suzana Shog
 Nënshkrimi i punonjësit të Bankës* / Signature of the Bank Employee
 Vula e Bankës* / Stamp of the Bank